

FJALA E DEPUTETES EVIS KUSHI

E ENJTE 13 TETOR 2022

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

E nderuar zonja Zhupa,

Dhjetë ditë më parë, gjatë fjalës që mbajta këtu në seancë, dhashë shpjegime në lidhje me vendimin e Këshillit të Ministrave për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor “Mehmet Akif Ersoy”, ku theksova se kjo është një çështje administrative, teknike, ligjore dhe nuk duhet të marrë përmasa politike. Megjithatë, në respekt të ligjit, në respekt të Rregullores së Kuvendit, por edhe të koleges Zhupa, jam e gatshme të jap edhe shpjegime të mëtejshme, të cilat, gjithashtu, janë të sqaruara në detaje edhe në relacionin e vendimin e Këshillit të Ministrave dhe në vendimin e Ministrisë së Arsimit.

Mua më vjen keq që ju në letër shkruani: “Sipas të dhënave në media, kemi të bëjmë me një vendimmarrje abuzive, të pajustificuar dhe totalisht vasale ndaj palëve të treta”. Kjo është ajo çfarë keni shkruar ju. E para, jo të gjitha mediat kanë dalë në këtë konkluzion, por në respekt të mediave, edhe të atyre që kanë dalë në konkluzion të gabuar, as ju dhe as ne, nuk mund t’u referohemi mediave për të vlerësuar ligjshmërinë e një vendimi. Ka institucione të tjera ligjore që e japin këtë vendim dhe ato janë organet e drejtësisë. Gjykata e ka thënë fjalën e parë edhe në rastin e kopshtit, edhe në rastin e shkollës, duke i dhënë të drejtë Ministrisë së Arsimit dhe Këshillit të Ministrave për mbylljen e këtyre dy institucioneve.

Sy dyti, në letrën tuaj ju thoni: “Heqja e licencave cenon të drejtën për shkollim të qindra fëmijëve”. Kjo deklaratë është një spekulim, është një abuzim sepse ne, menjëherë pas vendimit, morëm të gjitha masat për t’i regjistruar nxënësit në shkolla apo kopshte të tjera, sipas vendbanimit apo preferencave të tyre. Dhe sipas të dhënave nga Zyra Vendore Arsimore

Tiranë, sot në mëngjes, të gjithë nxënësit janë sistemuar në shkolla dhe në kopshte të tjera dhe po vijnë normalisht procesin mësimor.

Konkretisht, nga 159 nxënës të shkollës “Mehmet Akif Ersoy”, të gjithë u pajisën me dokumentacionin e nevojshëm dhe janë transferuar: 103 prej tyre kanë filluar mësimin në shkollën “Turgut Ozal” Durrës, 51 në “Turgut Ozal” Tiranë, 2 në gjimnazin “Elitë”, Tiranë, 1 në gjimnazin “Kristaq Rama”, 1 në gjimnazin “Raqi Qirinxhi” Korçë, dhe 1 në gjimnazin “Fuat Babani” Bilisht. I përmenda për të thënë dhe për të vërtetuar se nxënësve nuk u është cenuar e drejta kushtetuese për shkollim, sepse të gjithë tashmë janë sistemuar dhe si të gjithë nxënësit e tjerë po vijnë normalisht procesin mësimor.

Gjithashtu, në letër shkruani edhe diçka tjetër: “Çdo institucion privat arsimor nesër mund të jetë target i një vendimmarrjeje joligjore dhe abuzive nga ana e institucioneve shtetërore”. Po si mund të nxisni një konflikt të tillë midis institucioneve private dhe shtetit? Shteti nuk ka asnjë interes të abuzojë me bizneset, me institucionet e ndryshme, aq më pak me institucionet arsimore, përkundrazi i mbështet, i mbron interesat e tyre për sa kohë këto institucione respektojnë ligjin. Shteti nuk është Partia Socialiste, që t’i hidhni baltë në çdo moment. Shteti janë institucionet, janë njerëzit, janë profesionistët që kanë qenë aty, punojnë dhe do të punojnë gjithmonë.

Megjithatë, në lidhje me arsyet ligjore të vendimit që ju kërkoni në letër, për sa i takon shkollës “Mehmet Akif Ersoy”, ky institucion ka ndryshuar vendndodhjen, pa marrë miratimin nga Ministria e Arsimit, gjë që bie në kundërshtim me nenin 43, pika 2, të ligjit nr. 69 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”. Ky institucion arsimor i ka dërguar dy shkresa Ministrisë së Arsimit, por ministria nuk i ka miratuar për shkak se, pas inspektimit të kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, rezultoi mosrespektimi i standardeve ligjore, që lidhen me akt-miratimin higjienosanitar, me standardet e ndriçimit natyral të klasave, me palestrën, me mjetet didaktike për lëndën e edukimit fizik e të tjera.

Situata është e ngjashme edhe për kopshtin “Zubeyde Hanim”. Që në muajin maj Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar ka konstatuar ndryshimin e vendndodhjes dhe i rekomandon këtij institucioni marrjen e miratimit nga ministria, 3 muaj përpara fillimit të vitit

shkollor, siç e parashikon ligji. Jo një herë, por dy herë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar ka kryer inspektime pranë kopshtit, ku rezultoi se dhe atje nuk ishin zbatuar standardet sipas detyrimeve ligjore, prandaj i ka propozuar ministrisë heqjen e licencës. Në pamundësi, se koha është e kufizuar, për t'i renditur këtu të gjitha detajet, unë mund t'ju vë në dispozicion vendimin e Këshillit të Ministrave, vendimin e Ministrisë së Arsimit, relacionin, në mënyrë që edhe ju të keni të gjithë informacionin e plotë. Por më lejoni ta përsëris: e gjithë historia është çështje e zbatimit të ligjit.

Si institucionet, ashtu edhe individët kanë detyrimin e barabartë që të jenë korrekt dhe të respektojnë ligjin. Ky institucion dhe shumë të tjerë mund të kenë pasur vlerësime, por kjo nuk do të thotë që në momentin kur shkelin ligjin, me qenë se paska pasur një certifikatë nderi, të mos zbatohet ligji. Ligji do të zbatohet për të gjithë. Ne po përpiqemi, kemi marrë një iniciativë që të bëjmë rankimin e gjimnazeve, por ju e paskeni bërë dhe e paskeni nxjerrë. I paskeni kontrolluar ju, rreth 2 mijë godina shkollash dhe paskeni dalë në këtë konkluzion! Ju lutem, na e jepni listën e renditjes, se na kurseni kohën dhe punën e njerëzve! Faleminderit!